

Egjipt: Udhëtim në gjurmët e faraonëve**Cmimet :**

1820 Euro per person ne dhome teke

1580 Euro per person ne dhome dyshe/matrimoniale/treshe

Përshkrimi i shërbimit:

Udhëtim në Egjipt

Vizitë në Piramidat e Gizës dhe krociere në Nil.

Dita e parë, 21 Maj: Tirana – Cairo

Nisja nga Tirana dhe mbërritja në Cairo. Takimi dhe asistenca në aeroport me partnerët tanë. Transferohemi drejt hotelit. Akomodimi dhe fjetja në Cairo.

Dita e dytë, 22 Maj: Krocierë në Nil – High Dam – Liqeni Naser – Tempulli Philae Konsumojmë mëngjesin dhe transferohemi drejt aeroportit për të marrë fluturimin për në Aswan. Mbërrijmë në Aswan dhe nisim turin për të vizituar: High Dam dhe Liqeni Nasser. High Dam (Diga e larte) u ndërtua nga Britaniket në vitet 1898 – 1902. Në atë kohë ishte Diga më e madhe në botë, lartësia e të cilës u ngrit dy herë më shumë me qëllim për të kontrolluar prurjet e mëdha të lumit. Duke u shtrirë rreth 500 km nga Diga dhe me një thellësi mbi 180 metra, Liqeni Nasser është Liqeni më i madh artificial në botë. Krokodilët popullojnë më së shumti këtë liqen dhe janë një nga atraksionet më të rëndësishme për të gjithë vizitorët. Tempulli Philae: Në qendër të kultit të Isis, Ishulli Philae ka qenë një vend shumë i rëndësishëm pelegrinazhi për adhuruesit e tij deri në fillimin e Kristianizmit. Nga ky ishull besohet që Perendesha Isis vëzhgonte ishullin e shenjtë Biga, ku ishte varrosur burri i saj Osiris. Për tu vizituar në ishull janë Tempulli Isis, Porta e Hadrianit, Tempulli Hathorit, Tempulli i Trojanit, i Augustit dhe rrënojat e Dioklecianit. Përfundojmë turin dhe transferohemi për në Krocierë. Darka dhe fjetja në Krocierë.

Dita e tretë, 23 Maj: Krocierë në Nil – Kom Ombo

Gjatë lundrimit me Krocierë do të shijojmë pamjet e mrekullueshme të brigjeve të Nilit, të marrim rreze dielli dhe të freskohemi në pishinë. Hamë drekën dhe do të ndalojmë për të vizituar qytetin Kom Ombo, një qytet i këndshëm agrokulturor. Do të vizitojmë Tempullin e Kom Ombo, dedikuar 2 Zotave, Haroeris dhe Sibek. Aty do të shohim “mumjet” e krokodilëve të sjella nga varrezat e krokodilëve aty pranë. Kthimi në Krocierë ku mund të shijojmë darkën dhe të vazhdojmë lundrimin.

Dita e katërt, 24 Maj: Krocierë në Nil – Edfu -Tempulli i Horus – Bregu lindor i Luxorit

Konsumojmë mëngjesin dhe ankorohemi për të vizituar qytetin Edfu dhe Tempullin e Horusit. Ky qytet ndodhet pothuaj në mes të distancës midis Aswan dhe Luxor. Tempulli i Horusit, pothuaj 2000 vjet vjetër, i varrosur në rërë, është një nga tempujt më të mëdhenj Ptolemaik në Egjipt, ndërtuar në vitin 237 BC. Do të vazhdojmë lundrimin për në Luxor dhe më të mbërritur në Luxor do të lëmë anijen për të vizituar Bregun Lindor. Tempulli i Karnakut është ndalesa e

Elite Travel Agency

Rr. Kozma Naska, Nr: 33/6, 3001 Elbasan, Albania.

Rr. Faik Konica, 1000 Tirana, Albania

Telephone: +355 69 204 4656, Email: info@etg.al

www.elitetravel.al

parë dhe me pas Tempulli i Luxorit, në cdo metër katror të të cilit ka histori. Ndryshe nga cdo tempull tjetër në Egjiptin e Lashtë, ky tempull gjigand nuk i kushtohet asnjë Zoti, Kulti apo Faraoni, por i kushtohet procesit të ripërtëritjes mbretërore, ku bëheshin kurorëzimet e mbretërve. Koha më e bukur për ta vizituar këtë tempull është mbrëmja. Transferohemi në Krociere dhe darkojmë.

Dita e pestë, 25 Maj : Krociere në Nil – Bregu Perëndimor i Luxorit – Cairo Konsumojmë mëngjesin dhe do të vazhdojmë vizitën në Bregu Perëndimor të Luxorit.

Lugina e Mbretërve është ndalesa e parë. Kjo luginë ka qenë varreza e Mbretërve gjatë periudhës së Mbretërisë së re të Faraonëve (1500 BC). Lugina përmban varret me korridorë të gjatë dhe dhoma të gërrmuara thellë në kodrat e Thebanit. Po ashtu do të vërejmë muret e vizatuar, zbuluar me simbole dhe piktura të ritualeve të vdekjes & jetës pas vdekjes. Tempulli i Mbretëreshës Hatshepsut, i dizenuar nga arkitekti i saj Senenmut gjatë dinastisë së 18-të është një monument i jashtëzakonshëm që ngrihet nga sipërfaqja e shkretëtirës në një sërë terracash madhështore. Kolosat e Memnonit, 2 statujat madhështore 18 metra të larta të Amenhotepit të III-te, janë të parat monumente që bien në sy të vizitorëve sapo arrijnë në Bregun Perëndimor. Përfundojmë turin, transferohemi në aeroport për të marrë fluturimin për në Cairo. Mbërrijmë në Cairo, akomodohemi në hotel.

Dita e gjashtë, 26 Maj: Cairo – Piramidat e Gizës – Muzeu Egjiptian

Dita jonë nis me një mëngjes të bollshëm. Pas mëngjesit do të fillojmë turin tonë duke vizituar Piramidat e Egjiptit të lashtë.

Piramidat e Gizës janë nga monumentet më të rëndësishme të periudhës parahistorike në botë. Ato përbëhen nga tre Piramidat e Mëdha (Keopsi, Khafre, Menkauri) dhe të paktën gjashtë të tjera më të vogla. Po ashtu aty gjenden disa monumente të tjera të rëndësishme si Sfinksi i Madh dhe Lugina e Tempujve. Piramida e Madhe: Kjo piramidë është më madhështorja dhe më e vjetra në botë. E ndërtuar nga Dinastia e 4-rt Khufu (2589 – 66 BC), përbëhet nga rreth 2 milionë blloqe guri, secili me një peshë rreth 2.5 ton, duke përfshirë dhe disa blloqe të bazës që mendohet të peshojnë rreth 15 ton secili. Ky ndërtim i jashtëzakonshëm ka mbajtur vendin e parë në botë si ndërtesa më e lartë deri në shek 19-të. Sfinksi i Madh: I gdhendur në një shkëmb natyral është një nga monumentet më të mëdhenj në botë. Lugina e Tempujve të Faraonit Khafre: Ky vend shërbente si porta për të shkuar tek piramida duke kaluar në një rrugë të gjatë dhe kryesisht të mbuluar. E varrosur në rëre për shekuj, u zbulua vetëm në vitin 1852 nga Auguste Mariette. Ndalesa tjetër do të jetë Muzeu Egjiptian ku do të shikojmë mijera artefakte, koleksione dhe statuja të artit të lashtë Egjiptian. Më tej do të vizitojmë Khan El Khaili, tregu i artizanëve. Përfundojmë turin dhe transferohemi drejt Hoteli në Cairo.

Dita e shtatë, 27 Maj: Cairo – Tiranë

Konsumojmë mëngjesin, transferohemi drejt aeroportit të Kairos për të marrë fluturimin për në Tiranë.

Detajet e Turit

Elite Travel Agency

Rr. Kozma Naska, Nr: 33/6, 3001 Elbasan, Albania.

Rr. Faik Konica, 1000 Tirana, Albania

Telephone: +355 69 204 4656, Email: info@etg.al

www.elitetravel.al

Ju lutem shikoni më poshtë të gjitha detajet e Turit

Përfshihen në çmim

Fluturimi V/A Tirane – Cairo

3-netë akomodim në hotel në Kairo me mëngjes

3-netë akomodim në Krocieren e Nilit me Mëngjes+Drekë+Darkë 4-ditë ture – në Aswan & Luxor 1-ditë tur në Kairo

Fluturimi Cairo / Aswan & Luxor / Cairo. Guidë lokale në Anglisht Transport me autobus AC Vaktet sic përmenden në program Viza e hyrjes në Egjipt

Hyrjet në muze dhe monumente sic përmenden në program Guidë dhe shoqërues nga Shqipëria gjatë gjithë udhëtimit

NUK përfshihen në çmim

Cdo gjë që nuk përmendet në program

Bakshish për guiden dhe shoferin (pritshmëria është 5 usd/person/ditë) Ture opsionale Gjithcka që nuk përmendet në rubrikën “përfshihet”

Shumë e rëndësishme :

- ◆ Klienti duhet të paraqitet 3 orë përpara fluturimit në aeroport
- ◆ Pasaporta duhet të jetë e padëmtuar dhe brenda afatit të vlefshmërisë (6 muaj)

Fluturimi

Shqiperi – Egjipt 21 Maj Lufthansa:

TIA 14.35 – ZRH 16.40

ZRH 21.15 – CAI 02.15

Egjipt- Shqiperi 27 Maj 2024

CAI 16.45 – VIE 19.20

VIE 23.25 – TIA 00.55

Bagazhe 8 kg dore

Politikat e Shërbimit

Rezervimi me Elite Travel Agency është i sigurt dhe i thjeshtë

PA KOSTO TË FSHEHURA

Shikoni çdo çmim të mundshëm pa tarifa rezervimi ose kosto të tjera të fshehura.

SIGURI NË TRANSAKSIONET TUAJA

Ne ndjekim standardet më të larta të protokolleve të sigurisë për t'iu ofruar mysafirëve tanë siguri "online".

POLITIKAT E PRIVATËSISË

Ne interesohemi për privatësinë e të dhënave tuaja personale dhe marrim të gjitha masat për t'iu siguruar që jemi duke ecur me hapin e kohës përsa i përket rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT

Rezervimi në faqen tonë është i shpejtë dhe i thjeshtë. Nëse keni kërkesa specifike, ekipi ynë i Operacioneve do të jetë gati për t'ju asistuar.

KONFIRMIMI I REZERVIMIT ME E-MAIL

Menjëherë pasi të keni kryer rezervimin, një e-mail me të gjitha detajet e rezervimit do të vijë në adresën tuaj.

PAGESA PER REZERVIMIN

Pagesa per rezervimin do te kryhet ne dy pjese: 50% e pageses do te kryhet ne momentin e rezervimit, 50% deri ne 21 dite para nisjes

Nëse dëshironi të ndryshoni specifikat e rezervimit tuaj, mund të na kontaktoni në një nga numrat e telefonit ose me e-mail.

POLITIKAT E KANCELIMEVE

Ne rast te anulimit nga klienti aplikohen penalitetet si me poshte :

40 % nese anulimi behet deri 30 dite perpara nisjes

75 % nese anulimi behet 30 deri ne 15 dite perpara nisjes

100% nese anulimi behet 14 dite perpara nisjes

Nese klienti qe kerkon te anulloje udhetimin e zevendeson rezervimin e tij me nje person tjeter, atehere politikat e anulimeve do te diksutohen sipas rastit konkret.

Anullimi do të quhet se është kryer në momentin që klienti paraqitet personalisht (ose i përfaqësuar nga një pjestar i grupit kur udhëtimi është rezervuar në grup) në njërën nga zyrat e agjencisë ose duke dërguar e-mail në adresën info@etg.al për t'iu tërhequr nga marrëdhënia e krijuar me agjencinë.